



| nr. Rendor | Emer | Atësi | Mbiemer | Të dhënat e pasurisë | | |
|---------------|--------------|-------------|---------|----------------------|----------|----------------|
| | | | | Zona kadastrale | Adresa | Nr. i pasurisë |
| 1 | ARBEN/MERITA | AMBELI/ADEM | CANE | 3830 | VRESHTAS | 3/43 |



BASHKIA MA
Zyrtarë Prokuror
Nr. 798
Data 12.02.24
J. Kulem

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE KORÇË

Korçë, më 8.2.2024

Nr. 485/6 Prot.

Lënda: Kërkesë për publikim.

NJËSISË ADMINISTRATIVE VRESHTAS

Brenda kompetencave institucionale dhe tagrit ligjor të garantuar nga Ligji nr.111/2018 „ Për Kadastrën“, Ligjit nr. 20 dt.05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1040/2020 “ Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” Drejtoria Vendore e ASHK-së Korçë ka miratuar Vendimet për legalizimin e ndërtimeve pa leje në favor të subjekteve të poshtëshënuar.

Në zbatim të pikës 31 dhe 32 të VKM-së 1040/2020 ku parashikohet që “ Lista e subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara, shoqëruar me të dhënat e pasurive, si adresa , zona kadastrale, numri i pasurisë publikohet në ambientet e ASHK-së, pranë njësisë së vetqeverisjes vendore, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ASHK-së” dhe “ Subjektet e interesuara në përputhje me afatet e përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, kanë të drejtë të paraqesin ankim administrativ për vendimin e legalizimit , pranë strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së”, për sa më sipër kërkojmë:

- **Publikimin për afatin 30 (tridhjetë) ditor në ambientet e Institucionit tuaj së listës së mëposhtme të subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara.**
- **Çdo subjekt i cili ka pretendim apo ankesë në lidhje me vendimin e legalizimit është i lutur ti drejtohet strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së.**
- **Në përfundim të afatit jeni të lutur të konfirmoni nëse ka apo jo kërkesë/ankesa nga subjektet.**

Bashkëngjitur shkresës po ju vemë në dispozicion:

- Tabelën me listën emërore të subjekteve përfituese ku janë të përcaktuara të dhënat e pasurisë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

DREJTORI
Stavri Mushka
(me urdhër dhe delegim)
ZV/DREJTORI
Igli Radomi

Igli Radomi



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Korçë

Date: 2024/02/08 16:10:33 +0200

KORÇË, Korçë, www.ashk.gov.al, email: info@ashk.gov.al

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Korçë)

Nr. 34 POK